



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllogoc
Zyra e Personelit
01Nr. 111-4263 dt. 23.01/2020

Bazuar në nenin 12 ,paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Komuna Gllogoc/Drenas, Zyra e Personelit **shpallë:**

KONKURS PUBLIK
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Për angazhim afatshkurter konform nenit 12 paragrafit 4, të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta).

Titujt e vendeve të punës:

koefficientet:

I. Zyrtar në Stadiumin Sintetik -1(një) pozitë /DKRS	6
II. Zyrtar në Palestër Sportive - 1(një) pozitë/ DKRS	6
III. Mirëmbajtës- punëtor teknik në Stadiumin Sintetik - 2(dy) pozita/ DKRS	5.5
IV. Mirëmbajtës- punëtor teknik në Palestër Sportive - 2(dy) pozita/ DKRS	5.5
V. Zyrtar për bujqësi – 2 (dy) pozita /DBPZHR	6
VI. Zyrtar për Shërbime Sociale – 2 (dy) pozita/QPS	5

Detyrat e punës

I. Një Zyrtar në Stadiumin Sintetik-Drenas

- Mirëmbajtja e objektit
- Mbikëqyrja e aktiviteteve
- Përpilimi i orarëve
- Pritjen dhe përcjelljen e pjesëmarrësve në gara dhe ushtrime
- Përpilimin e raportit ditor, mujor etj

Kualifikimet e nevojshme:

Diplomë Universitare, Fakulteti i Shkencave Sportive

II. Një Zyrtar në Palestër Sportive-Drenas

- Mirëmbajtja e objektit
- Mbikëqyrja e aktiviteteve
- Përpilimi i orarëve
- Pritjen dhe përcjelljen e pjesëmarrësve në gara dhe ushtrime
- Përpilimin e raportit ditor, mujor etj

Kualifikimet e nevojshme:

Diplomë Universitare, Administratë Publike, Fakulteti i Shkencave Sportive

III. Dy Mirëmbajtës – punëtor teknik në Stadiumin Sintetik

- Ruajtja e objektit dhe e fushës, pastrimi, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara për rreth objektit, mirëmbajtja e higjienës brenda dhe për rreth objektit, sanimi i defekteve eventuale.

Kualifikimet e nevojshme:

Shkolla e mesme.

IV. Dy Mirëmbajtës – punëtor teknik

- Ruan objektin sportive,
- Mirëmban nyjet sanitare
- Kujdeset dhe mirëmban hapësirat gjelbëruese rreth palestrës sportive,
- Kujdeset rreth mirëmbajtjes së objektit,
- Kujdeset për lokalet tjera përcjellëse të objektit
- Kryen punë dhe detyra tjera sipas urdhërit të mbikëqyerësit në pajtim me ligjin.

Kualifikimi i nevojshëm:

Shkolla e mesme

V. Dy Zyrtar për bujqësi

- Pranimi dhe sistemimi i të gjitha Aplikacioneve të fermerëve;
- Udhëzimi – dhenja e konsulencave të gjithë fermerëve për përgatitjen dhe kopletimin e aplikacioneve për programin e pagesave direkte për subvencione si dhe Grante sipas kriterëve të caktuara nga MBPZHR.
- Identifikimi i parcelave dhe futja në sistemin elektronik i të dhënave për të gjithë aplikuesit;
- Përgatitja e raporteve ditore, javore dhe mujore rrethë ecurive të proqesit të aplikimit në programin e pagesave direkte për të gjitha nënsektorët e Bujqësisë;
- Evidentimi , klasifikimi dhe sistemimi i të dhënave për sipërfaqet e mbjellura sipas kulturave Bujqësore .
- Krijimi i databazeve për të gjitha nënsektorët e Bujqësisë;
- Kryejnë punë dhe detyra sipas nevojave në kuadër të DBZHE – së.

Kualifikimet e nevojshme:

Diplomë Universitare, Fakulteti i Bujqësisë- Agroekonomi
Përvoja e preferueshme; së paku 1 vit përvojë pune
Njohja e programit Microsoft office dhe Excel
Trajnime dhe Çertifikata, Referenca në lëmin e Bujqësisë

VI. Dy Zyrtar për Shërbime Sociale 2

Përshkrimi i vendit të punës:

- Ofron shërbime në mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, birësim, strehim;
- Bën mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delikumente;

- Ndihton rastet e abuzimit dhe lënies pas dore të fëmijëve;
- Punon në sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore dhe familjare;
- Trajton rastet e dhunës në familje dhe rastet e trafikimit me qenie njerëzore;
- Punon në mbrojtjen e të moshuarve dhe bën mbrojtjen e tyre dhe strehim;
- Mban dosjet e lëndëve dhe dokumentacionin, si dhe futja e lëndëve në bazën e të dhënave;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor,(aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës):

Diplomë universitare;

Fakulteti Filozofik- Drejtimi Sociologji, Psikologji, Punëtor Social, Fakulteti Juridik

Njohje kompjuterike të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin;

Aftësia për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion;

Njohuri substanciale në lëminë e shërbimeve sociale;

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **23/01/2020** deri më **30/01/2020**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Kohëzgjatja e angazhimeve prej nr.I-V është 5.5 muaj, ndërsa për 2 pozitat Zyrtar për Shërbime Sociale kohëzgjatja e angazhimeve është 5 muaj.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këtë vend pune, për të cilin konkurohet.



Zyra e Personelit

[Handwritten signature]